

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I PËR APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-111/11**

**Prishtinë, 8 mars 2012**

Në procedurën e:

**A.S.**

*Pala përgjegjës në kërkesë/Pala ankuese*

Kundër

**G.M.**

*Paraqitësi i kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë*

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Gjyqtarë, në lidhje me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPKK/D/A/60/2010 (lënda është e regjistruar në AKP me numrin KPA35695), të datës 25 shkurt 2010, pas shqyrtimit të mbajtur me 8 mars 2012, mori këtë:

## AKTGJYKIM

- 1- Pranohet si e bazuar ankesa e A.S..
- 2- Priset vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/60/2010, i datës 25 shkurt 2010, për sa i përket lëndës së regjistruar me numrin KPA35695 dhe që ka të bëjë me pronësinë e palës përgjegjëse në ankesë, dhe lënda i kthehet KKPK-së për rishqyrtim..
- 3- Shpenzimet e procedurës do të vendosen nga KKPK-ja.

### Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Me 12 prill 2007, G.M. ka paraqitur në emër të gjyshes së tij një ankesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar që gjyshja e tij të njihet si pronare e ngastrës së tokës dhe ka kërkuar ririposimin si dhe kompensimin për shfrytëzimin e saj. Ai ka pohuar se gjyshja e tij kishte qenë pronare e ngastrës nr. 996, që ndodhet në vendin e quajtur “Livoc”, zona kadastrale e Livoçit të Ultë, në Komunën e Gjilanit, arë e klasës 1 me sipërfaqe prej 70 ari e 74 m<sup>2</sup>, dhe se ngastra ishte humbur me 16 janar 1999 si rezultat i rrethanave të vitit 98/99 në Kosovë.

Për të mbështetur kërkesën e tij, ai ka paraqitur në AKP këto dokumente:

- Fletën poseduese nr. 354 të Komunës së Gjilanit, zona kadastrale e Livoçit të Ultë, të datë 19 prill 1984, e cila tregon se ngastra e kërkuar si dhe ngastrat tjera ishin regjistruar në emër të (I.)S.M.;
- Certifikatën e vdekjes të lëshuar nga Komuna e Kragujevcit me 6 tetor 2006, e cila tregon se në librin amzë të të vdekurve për Komunën e Grosnices në numrin 20 të vitit 2006 është regjistruar se M.M., emri i nënës së të cilit ishte S.M., kishte vdekur me 30 shtator 2006 në Grosnica, Kragujevc;
- Certifikatën e lindjes të lëshuar nga Komuna e Gjilanit (Republika Federative e Serbisë) me 29 tetor 2002, e cila tregon se emri i babait të paraqitësit të kërkesës ishte M.M.;
- Vendimin nr. VR.nr.268/07 të Gjykatës Komunale të Kragujevcit, të lëshuar me 24 maj 2007, sipas të cilit G.M. ishte trashëgimtar i të ndjerit M.M..

Me 5 qershor 2008, ekipi për njoftimi i AKP-së ka shkuar në vendet ku pretendohet se ndodhet ngastra e kërkuar dhe ka vendosur shenjën që tregon se prona ishte subjekt i kërkesës dhe se palët e interesuara do të duhej të paraqitnin përgjigjet e tyre brenda 30 ditëve. Prona është gjetur e mbjellë, por pasi që vendasit nuk ishin të gatshëm të bashkëpunonin me ekipin, uzurpuesi nuk ka mundur të gjendet.

Njoftimi është përsëritur me 13 janar 2010. Prona prapë është gjetur e uzurpuar, megjithatë personi i cili kishte uzurpuar pronën nuk ka mundur të gjendej. Të nesërmen, njoftimi është kontrolluar me anë të koordinatave ortofotografike dhe GPS-it dhe është gjetur të ketë qenë i saktë.

Në ndërkohë, AKP-ja ka qenë në gjendje të verifikojë fletën poseduese. Një certifikatë mbi të drejtat pronësore është lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunale e Gjilanit me datën 25 qershor 2008 (UL-70403020-00354), e cila tregon se parcela kontestuese ishte në posedim të S.(I.)M.. AKP-ja po ashtu është njoftuar nga nëna e paraqitësit të kërkesës se S.M. ishte gjyshja e paraqitësit të kërkesës.

Me 12 shkurt 2010, A.S. kishte vizituar zyrat e AKP-së. Ai është përgjigjur në kërkesë, duke cekur se kishte të drejtë ligjore mbi pronën. Në deklaratën e tij me shkrim ai ka sqaruar se e kishte blerë pronën në vitin 1996 në shumën prej 21.000 DM. Shitësi kishte qenë i biri i pronarit, T.M., me të cilin ai kishte lidhur një kontratë gojore. Ai ka deklaruar se e kishte shfrytëzuar ngastrën që nga viti 1996 pa ndonjë problem.

Në raportin e saj të procedimit të datës 22 dhjetor 2009, AKP-ja e kishte proceduar kërkesën – në atë kohë drejtësisht– si të pakontestuar.

Me 25 shkurt 2010, KKPK-ja në vendimin e vet KPCC/D/A/60/2010 po ashtu e kishte konsideruar kërkesën si të pakontestuar (paragrafi 9 i vendimit) dhe kishte vendosur se paraqitësi i kërkesës e kishte vërtetuar pronësinë e tij të bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore. KKPK-ja e kishte hedhur poshtë kërkesën për kompensim të fitimit të humbur për shkak të mungesës së juridiksionit.

Vendimi i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës me 2 mars 2011. Me 8 korrik 2011, vendimi i është dorëzuar palës përgjegjëse në kërkesë, A.S..

Me 2 gusht 2011, pala përgjegjëse në ankesë (më tutje në tekst: pala ankuese) ka paraqitur një ankesë në Gjykatën Supreme kundër vendimi të lartpërmendur, i cili, sipas tij përmbante shkelje thelbësore të dispozitave të së drejtës së zbatueshme procedurale ose materiale dhe është bazuar në gjendjetë gabuar dhe jo të plotë faktike si vlerësim të gabuar të provave.

Pala ankuese ka deklaruar se dispozitivi ishte në kundërshtim me arsyetimin dhe veç kësaj arsyetimi ishte edhe i paqartë. Ai po ashtu ka bërë kritika se gjendja faktike nuk është vërtetuar drejt pasi që ai e kishte blerë pronën në vitin 1996 ashtu siç e kishte përmendur në përgjigjen e tij në kërkesë.

Prandaj, palës ankuese nga kërkuar nga Gjykata Supreme që të ndryshojë vendimin e KKPK-së, të aprovojë ankesën e tij dhe ta njohë atë si pronar të ngastrës nr. 996.

Version i përkthyer i ankesës i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës (më tutje në tekst: pala përgjegjëse në ankesë) me 27 tetor 2011, por ai nuk është përgjigjur.

### **Arsyetim ligjor:**

Ankesa është e pranueshme dhe e bazuar. Kështu që, vendimi i KKPK-së duhet të priset. Pasi që arsyetimi i palës ankuese nuk është marrë parash nga KKPK-ja, lënda duhet të kthehet në KKPK për rishqyrtim.

Ankesa është e pranueshme. Pala ankuese e ka paraqitur kërkesën e tij brenda afatit të përcaktuar me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079.

Vendimi i KKPK-së duhet të priset dhe lënda duhet të kthehet për rishqyrtim pasi që gjykata ka vërejtur aplikim të gabuar të dispozitave ligjore të së drejtës materiale.

Neni 11.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 parasheh: *“Komisioni i merr vendimet në bazë të kërkesës dhe përgjigjes apo përgjigjeve”*. Megjithatë, në këtë rast, Komisioni nuk e ka marrë parasysh deklaratën e palës përgjegjëse në kërkesë ndonëse Komisioni ka qenë i obliguar të bëjë këtë.

Neni 10.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 parasheh: *“Çdo person, përveç paditësit, i cili aktualisht ushtron ose pretendon se ka të drejtë në pronën e cila është objekt i kërkesës*

[...]është palë në këtë kërkesë dhe në procedurat e përfaqësuara, me kusht që personi i tillë ta informojë Sekretarinë ekzekutive për qëllimin e tij që të marrë pjesë në procedurën administrative brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi për kërkesën [...]”. Sipas dosjes së lëndës, pala ankuese ka reaguar ndaj kërkesës me 12 shkurt 2010, brenda afatit prej tridhjetë ditëve pas njoftimit të kërkesës me 13 janar 2010..

Megjithatë, se Komisioni nuk e ka marrë parasysh deklaratën e palës ankuese – mbase duke qenë i lajthitur – konkludohet nga raporti i datës 22 dhjetor 2009, në të cilin lënda është trajtuar si e pakontestuar. Po ashtu, në vendimin e vet, KKPK-ja në numrin 9 përmend se kërkesat janë të pakontestuara në kuptim se asnjë palë nuk e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda periudhës 30 ditore siç parashihet me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079.

Megjithatë, pala zakonisht ka të drejtë të dëgjohej jo vetëm nga një instancë (në këtë rast: ankimore), por të dëgjohej nga së paku dy instanca. Nëse pala – sikurse në këtë rast - privohet nga kjo e drejtë si pasojë e gabimit esencial të instancës së parë, kjo duhet të konsiderohet si shkelje esenciale dispozitave procedurale. Gjithashtu, gjykata gjen shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore (neni 182.1 i Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore në lidhje me nenin 13.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079). Fakti se Komisioni nuk e ka marrë parasysh përgjigjen paraqet një shkelje po aq serioze të ligjit sikurse shkeljet e përmendura në nenin 182.2 (h) dhe (i) – duke nxjerrë një aktgjykim në bazë të dështimit të palës për të vepruar siç është kërkuar apo mungesës së saj në kundërshtim me dispozitat e ligjit. Rrjedhimisht, lënda duhet të kthehet për rigjykim dhe rivendosje (neni 195.1 (c) i Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore), madje edhe pse gjykata është në dijeni se procedurat e AKP-së dhe Kolegjit të Apelit të AKP-së duhet të jenë të shpejta.

Në procedurën e re, KKPK-ja duhet ta ketë parasysh nëse kërkesa i plotëson kërkesat e nenit 5.2 të Urdhërësës Administrative 2007/05 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 (“Në procedurën para Komisionit, në rast se personi fizik nuk është në gjendje të bëjë kërkesë, kërkesa mund të bëhet nga ...”) ndonëse sipas nenit 9 të vendimit thuhet se “nuk është paraqitur anojë prove e pranueshme nga paraqitësi i kërkesës e cila do ta vërtetonte vdekjen”. Gjithashtu, KKPK-ja duhet t’i konsiderojë argumentet e palës ankuese.

Me qëllim të sqarimit, gjykata vëren se vendim i KKPK-së nuk është kundërshtuar dhe nuk është prishur deri me tani pasi që Komisioni e ka hedhur poshtë kërkesën për kompensim të palës përgjegjëse në ankesë.

### **Shpenzimet e procedurës:**

Pasi që vendimi i KKPK-së është prishur dhe lënda është kthyer për rigjykim, shpenzimet e procedurës do të vendosën nga KKPK-ja si instancë e parë (neni 166.3 i Ligjit për Procedurën Kontestimore).

### **Këshillë juridike**

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

*Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX*

*Sylejman Nuredini, Gjyqtar*

*Elka Ermenova, Gjyqtare e EULEX-it*

*Urs Nuffer, Referent i EULEX-it*